Kronikë

Arrestohet Andrea Bregasi, autori i atentatit të dështuar në 'Don Bosko'! Qëlloi drejt makinës ku ishin 3 persona! Në Durrës u kap me pistoletë në hyrje të pallatit

Policia e Durrësit ka arrestuar autorin e dyshuar të atentatit të dështuar në dhjetorin e kaluar në Tiranë kur u tentua të vritej pronari i një dyqani në zonën e Medresë në Tiranë. ***Policia kishte vënë 5 mijë euro për kokën e tij***



Andrea Bregasi me cigare pak para atentatit në dhjetor 2023/ Foto profili

Redaksia
11 Korrik, 11:39 | **Përditesimi: 11 Korrik, 15:31**

Share

DURRËS- Në dhjetor 2023 Rudolf Zefi pronari i një dyqani në zonën e Medresesë në Tiranë i shpëtoi atentatit pasi drejt makinës me të cilën po udhëtonte në rrugën "Don Bosko" u qëllua me 6 plumba. Disa orë më vonë policia identifikoi autorin si Andrea Bregasi ndërsa në ***një video të publikuar*** nga Report Tv dhe Shqiptarja.com autori lëviz qetësisht me cigare në dorë pak para se të qëllonte në drejtim të makinës së Rudolf Zefit, 42 vjeç ku po udhëtonin dhe dy persona të tjerë.

Shtatë muaj më pas, policia e Durrësit informoi se ka arrestuar *33 vjeçarin Bregasi në hyrje të një pallati në lagjen nr. 11. Të riut nga Tirana i është sekuestruar dhe pistoleta me* 9 fishekë.

Operacioni u kodua "Precedenti" dhe policia kishte pasur informacion për 33 vjeçarin që po lëvizte i armatosur në qytetin e Durrësit.

[Sh].com

LEXO EDHE:
I vihet flaka gjatë natës makinës së kryeinxhinierit të OSHEE në Durrës, dyshohet për shkak të detyrës

> *'Gjatë këtij operacioni, në hyrje të një pallati në lagjen nr. 11, u arrestua në flagrancë Andrea Bregasi. 33 vjeç, banues në Tiranë. Nga kontrolli në çantën e 33-vjeçarit, shërbimet e Policisë gjetën 1 armë zjarri pistoletë me municion luftarak, që posedohej pa leje. Në vijim, pas verifikimeve rezultoi se shtetasi ishte në kërkim nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, për veprën penale "Vrasja me dashje", mbetur në tentativë" informoi sot policia e Durrësit.*

Operacini u krye nga *Komisariati i Policisë Durrës, në bashkëpunim me Forcën e Posaçme "Shqiponja" të Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës*
Kush eshtë Andrea Bregasi?

Andrea Bregasi rezulton të jetë i dënuar më herët për grabitje me armë në një argjendari. Ai është liruar në dhjetor 2022 nga burgu, ku ka vuajtur dënim për grabitje. Për arrestimin e tij si autori i atentatit të dështuar të ndodhur më 14 dhjetor 2023, policia kishte vënë në dispozicion ***5 mijë euro për kokën e tij.***

Xh.K/Sl.E./Shqiptarja.com

TAG: atentat | don bosko | rudolf zefi | Durres | andrea bregasi

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH .COM

Sondazhi i ditës:
A jeni dakord me propozimin e PS-së për votimin e diasporës me Postë?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Armë dhe drogë në Durrës/ Drejtori i shkollës artistike u arratis nga avllia kur pikasi policinë! Zbardhen detaje nga dosja
Artur Korriku
8 Korrik, 17:14



Vangjush Dako kërkoi gjykim të shkurtuar, vendimi i GJKKO-se shtyhet për më 19 korrik
8 Korrik, 14:47



Durrës/ U kapën për drogë dhe armëmbajtje pa leje, caktohen masat e sigurisë për 15 të arrestuarit! Familjarët shpërthejnë në të qara gjatë seancës
Artur Korriku
8 Korrik, 13:55

Pushimet kthehen në tragjedi për familjen sllovake, humbin vajzën 8 vjeçe në aksident tek Gjiri i Lalzit! Arrestohet shoferi 18 vjeçar
Artur Korriku
8 Korrik, 09:43

Tragjike në Gjirin e Lalëzit/ 8 vjeçarja sllovake humb jetën pasi e përplas makina e 18 vjeçarit (EMRI)
7 Korrik, 21:10

Durrës/ Baritoni Gëzim Myshketa koncert pas 12 vitesh në vendlindje
Aldo Mustafa
7 Korrik, 17:48

Mbërrijnë varkat me vela në brigjet e Durrësit, për herë të parë zhvillohet gara nën monitorimin e Ministrisë së Mbrojtjes italiane
7 Korrik, 16:47

Qendra për grupet në nevojë në Durrës, Lezhë e Kurbin: Nga shërbime shëndetësore te aktivitetet argëtuese për fëmijë
7 Korrik, 11:00

Kallashnikovë, pushkë e pistoleta, zbulohet arsenal armësh në Durrës! Në kërkim drejtori i shkollës së Muzikës, me armë në banesë! Agjentët i bleně drogë (EMRAT + VIDEO)
7 Korrik, 09:46

Pësuan arrest kardiak në det, vdesin 2 persona
4 Korrik, 11:14

Aksident me motor në autostradën Tiranë - Durrës, vdes 35 vjeçari
4 Korrik, 10:18

Durrës/ Shfrytëzonin fëmijët 1-3 vjeç për të lypur, në hetim 3 persona
3 Korrik, 15:39

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje